# DËSHMI ARKIVI

**A-471045**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Jude Bellingham shpallet lojtari i vitit në Angli për të dytin vit radhazi |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394247.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 09:54:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 09:46:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 09:45:00 UTC → 26 shtator 2026, 09:47:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e4c2d881842035913419dee54f43491d73c24cfb8bee92bbc25034dbd2f378c8` |
| TEKSTI | `3d2323e9937738eff687cab027bd0fd07d317955840de1276d82bb0413428324` |
| PAMJA | `62a0252ea6a16ec5e6a566b51370fac41d0e3ff360d4fc9163b35c0ef2a0b449` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6e439c159fae13345b0b6cffecb1f0fa19dc618b07fd5cf55ac02acd8bddd35e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `bbc3301522765d1bd7c753c64180377d11d281903b5d3d3b2cb5e4d7203a8042` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6e439c159fae13345b0b6cffecb1f0fa19dc618b07fd5cf55ac02acd8bddd35e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Jude Bellingham shpallet lojtari i vitit në Angli për të dytin vit radhazi

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 26.09.2026, 11:46

Share Share



Jude Bellingham është shpallur për të dytin vit radhazi "Lojtari i Vitit" i Anglisë, pas një tjetër paraqitjeje të jashtëzakonshme me kombëtaren.

Mesfushori i Real Madrid shënoi 7 gola në Kupën e Botës 2026, duke vendosur një rekord të ri për numrin më të madh të golave të shënuar nga një futbollist anglez në një edicion të vetëm të Botërorit.

Pavarësisht humbjes dramatike ndaj Argjentinës në gjysmëfinale, Bellingham ishte një nga protagonistët kryesorë të rrugëtimit të Anglisë, e cila siguroi vendin e tretë pas fitores 6-4 ndaj Francës në ndeshjen për medaljen e bronztë.

Bellingham spikati veçanërisht në fazën me eliminim direkt. Ai shënoi dy gola ndaj Meksikës në fitoren 3-2 në fazën e 1/8-ve, ndërsa realizoi sërish dopietë në çerekfinale ndaj Norvegjisë.

Çmimi u përcaktua nga votat e tifozëve, ndërsa vetë Bellingham e cilësoi atë si një nder të madh.

"Është një ndjesi fantastike. Është një nder i madh të vlerësohesh sërish nga tifozët. Nuk është diçka që e mendon kur luan për kombëtaren, por sigurisht që është një shtesë e bukur në një verë të madhe për ne", u shpreh ai.

Trajneri i Anglisë, Thomas Tuchel, vlerësoi maksimalisht paraqitjet e mesfushorit madrilen, duke e konsideruar atë ndër lojtarët më të spikatur të turneut.

"Ai ishte një nga lojtarët e turneut, jo vetëm për ne, por në përgjithësi. Tregoi potencialin e tij të plotë. Është një konkurrues i jashtëzakonshëm dhe një makineri. Nën presion ai bëhet edhe më i fortë dhe pikërisht në këto momente jep më të mirën", tha Tuchel.

Tashmë Anglinë e pret një tjetër sfidë të madhe, teksa të shtunën në "Wembley" do të përballet me Spanjën, kampionen e botës, në një përballje të rëndësishme të Nations League. Më pas, "Tre Luanët" do të kenë përballje me Kroacinë dhe Çekinë.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.